



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.104 dt.24.07.1998

PER
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN QERSHOR 1998

Në bazë të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ndryshimeve të tij si dhe të vendimeve dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli Bashkiak i Tiranës pasi shqyrtoi relacionin, projekt vendimin, borderotë dhe proces verbalin e mbajtur nga Komisioni Ekonomik dhe i Përkrahjes Sociale me dt.17.07.1998 për dhënie e ndihmës ekonomike për muajin qershor 1998

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **9823 familje** gjithsej me një fond prej **30.810.748** lekë. Për çdo njësi administrative si vijon :

NJ.A.	FAMILJE	FONDI	NJ.A.	FAMILJE	FONDI
1.	855	2.663.167	7.	719	2.276.852
2.	893	2.662.467	8.	683	2.108.361
3.	815	2.550.525	9.	810	2.540.479

4.	1.220	3.881.029	10.	549	1.609.150
5.	1.137	3.601.276	11.	969	3.244.548
6.	1.173	3.672.894			
			Gjithsej	9.823	30.810.748

2. Të miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje sipas relacionit.
3. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike **205 familje** sipas pasqyrave përkatëse (dalje nga skema).
4. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike (dalje nga skema) **9 familje** për mostërheqje lekësh brenda afatit : Alush Fjolla, Astrit Hajro, Harilla Mece, Hatixhe Korra,Nj.A.7, Luan Daci, Roland Kote, Jonuz Zgura, Nj.A.5, Mimoza Pasha, Gazmir Zenuni, Nj.A.11.
5. Të rihyjnë në skemën e ndihmës ekonomike **77 familje** sipas listës përkatëse në relacion.
6. Të trajtohen me ndihmë ekonomike në nivelin maksimal për familjet me 1 antar Gjike Canaj, Nj.A.1, dhe Bujar Tomini, Nj.A.3.
7. Të trajtohet me ndihmë ekonomike si rast i veçantë për 5 muaj Ymer Beqiri, familje me 8 antarë Nj.A.2.
8. Nuk miratohet kërkesa për rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike e Irini Gjinerari, Ismail Kaziu dhe Haxhi Kaziu.
9. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për paaftësi **1827 persona** me aftësi të kufizuar dhe **176 persona** për përkuqdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar, gjithsej me një fond prej **6.624.020 lekë**.

10.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve të Jashtme, Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme dhe ekonomistët e njësive administrative.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI